

# **VIG SERVICES SHQIPERI SH.P.K.**

**Pasqyrat Financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

## Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur .....	i
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e performancës .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
1. Informacion i përgjithshëm.....	5
2. Bazat e përgatitjes .....	5
3. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë .....	8
4. Depozita me afat .....	8
5. Llogaritë e arkëtueshme .....	8
6. Aktive të tjera .....	8
7. Aktive afatgjata materiale .....	9
8. Aktivitet afatgjata jo-materiale.....	9
9. Llogaritë e pagueshme.....	10
10. Provizione.....	10
11. Llogari të tjera të pagueshme .....	10
12. Kapitali .....	10
13. Të ardhurat.....	11
14. Shpenzime personeli .....	11
15. Shpenzime administrative .....	11
16. Shpenzime për tatim fitimin.....	12
17. Palët e lidhura.....	12
18. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara .....	13
19. Ngjarje pas datës së raportimit .....	13

# **VIG Services Shqipëri SH.P.K.**

*Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe*

---

## **Raporti i audituesit të pavarur**

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

## Pasqyra e pozicionit financiar

<b>AKTIVET</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Mjete monetare	3	6,058,502	19,794,179
Depozita me afat	4	10,033,288	-
Llogari të arkëtueshme	5	11,028,945	7,206,579
Parapagim tatim fitimi		-	208,721
Aktive të tjera	6	2,644,121	3,049,772
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>29,764,856</b>	<b>30,259,251</b>
Aktive afatgjata materiale	7	20,251,965	17,076,419
Aktive afatgjata jo-materiale	8	12,489,080	16,719,337
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>32,741,045</b>	<b>33,795,756</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>62,505,901</b>	<b>64,055,007</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrimet</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	9	2,427,292	4,230,677
Provizione	10	5,123,572	5,123,572
Detyrim për tatimin mbi fitimin		209,824	-
Llogari të tjera të pagueshme	11	1,241,728	1,426,289
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>9,002,416</b>	<b>10,780,538</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>9,002,416</b>	<b>10,780,538</b>
<b>Kapitali:</b>			
Kapitali i paguar	12	42,339,750	42,339,750
Fitimet e pashpërndara		11,163,735	10,934,719
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>53,503,485</b>	<b>53,274,469</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>62,505,901</b>	<b>64,055,007</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtuesit e VIG Services Shqipëri SH.P.K më datën \_\_\_\_\_ 2024 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

Ilir Elmazi  
Administator

Ardita Gjika  
Kontabiliste

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

*Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe*

## Pasqyra e performancës

	Shënime	2023	2022
Të ardhurat nga veprimtaria	13	60,894,750	58,886,387
Të ardhura të tjera	13.1	12,000	152,973
Shpenzimet e personelit	14	(14,622,595)	(13,659,282)
Shpenzime administrative	15	(36,426,287)	(36,302,246)
Amortizimi	7,8	(9,022,688)	(8,186,998)
<b>Fitim nga veprimtaria operative</b>		<b>835,180</b>	<b>890,834</b>
Të ardhura interesi nga depozita	4	33,288	-
Humbje neto nga kurset e këmbimit		(220,907)	(191,031)
<b>Kosto financiare neto</b>		<b>(187,618)</b>	<b>(191,031)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>647,561</b>	<b>699,803</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	16	(418,545)	(198,358)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>229,016</b>	<b>501,445</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

*Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe*

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali i paguar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>30,046,758</b>	<b>10,433,274</b>	<b>40,480,032</b>
Fitimi i vitit	-	501,445	501,445
Rritje e kapitalit të ortakëve	12,292,992	-	12,292,992
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>42,339,750</b>	<b>10,934,719</b>	<b>53,274,469</b>
Fitimi i vitit	-	229,016	229,016
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>42,339,750</b>	<b>11,163,735</b>	<b>53,503,485</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

## Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	2022	2021
<b>Aktiviti i shfrytëzimit</b>			
Fitimi para tatimit		647,561	699,803
Amortizimi	7,8	9,022,688	8,186,999
Pakësim i aktiveve afatgjata materiale		-	151,072
<b>Paraja nga shfrytëzimi para ndryshimeve në kapitalin punues</b>		<b>9,670,249</b>	<b>9,037,874</b>
(Rritje)/rënie në llogaritë e arkëtueshme		(3,822,367)	3,956,694
Rënie në te arkëtueshme të tjera		405,651	865,876
Rënie në llogaritë e pagueshme		(1,803,385)	(5,722,129)
Rënie e detyrimeve të tjera dhe provizione		(184,561)	(1,273,129)
		<b>4,265,587</b>	<b>6,865,186</b>
Tatim Fitimi i paguar		-	-
<b>Flukset monetare nga shfrytëzimi</b>		<b>4,265,587</b>	<b>6,865,186</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	7	(7,967,978)	(5,186,127)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	8	-	(9,286,436)
Vendosje depozitë me afat		(10,033,288)	-
<b>Flukset monetare të përdorura në investim</b>		<b>(18,001,266)</b>	<b>(14,472,563)</b>
<b>Aktivitetet financiare</b>			
Kontribut i ortakëve përmes rritjes së kapitalit		-	12,292,992
<b>Flukset monetare nga financimi</b>		<b>-</b>	<b>12,292,992</b>
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		<b>(13,735,678)</b>	<b>4,685,615</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë në 1 janar	3	<b>19,794,179</b>	<b>15,108,564</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor</b>	<b>3</b>	<b>6,058,502</b>	<b>19,794,179</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

*Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe*

### 1. Informacion i përgjithshëm

VIG Services Shqipëri SH.P.K. ("Shoqëria") u themelua në Tiranë, Shqipëri më 22 dhjetor 2011. Ortakët e shoqërisë janë Sigma Vienna Insurance Group SH.A. dhe Intersig Vienna Insurance Group SH.A. secila zotëruese e 50% të kuotës së kapitalit. Dy ortakët ushtrojnë kontroll të përbashkët. Shoqëria kontrolluese fundore është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverwaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

**Aktiviteti kryesor:** Shoqëria është themeluar për të vepruar si një qendër shërbimesh për shoqëritë e Vienna Insurance Group që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.

**Adresa e selisë kryesore të biznesit** është në Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2023, Shoqëria kishte 4 punonjës (2022: 4).

**Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare:** Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar, e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha e mjedisit ekonomik kryesor ku shoqëria kryen veprimtarinë e saj, që është Republika e Shqipërisë.

### 2. Bazat e përgatitjes

**Baza e përgatitjes.** Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) bazuar në parimin e kostos historike. Politikat kontabël të detajuara në vijim janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme ndaj të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare përveç rasteve kur në këto pasqyra është shprehur ndryshe.

**Përdorimi i çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël.** Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SKK kërkon nga drejtuesit të përdorin çmuarje të rëndësishme kontabël dhe kërkon gjithashtu ushtrimin e gjykimeve kontabël nga ana e tyre në zbatimin e politikave kontabël. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto çmuarje. Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e çmuarjeve kontabël regjistrohen në periudhën kur është kryer rishikimi. Drejtuesit besojnë se supozimet mbështetëse janë të përshtatshme dhe që pasqyrat financiare paraqesin pozicionin financiar dhe performancën e shoqërisë në mënyrë të drejtë. Zërat e pasqyrave financiare që kërkojnë nivel më të lartë gjykimi apo kompleksiteti dhe supozimet përkatëse kanë paraqitur në shënimet përkatëse shpjeguese (shënimi 10). Përdorimi i tyre mbetet i kufizuar në këto pasqyra financiare.

**Parimi i vijmësisë.** Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijmësisë, sipas të cilit shoqëria do të vijojë aktivitetin e saj në mënyrë të pa-ndërprerë në të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij supozimi drejtuesit morën në konsideratë pozicionin financiar dhe pritshmërinë e ardhshme për përfitueshmërinë e veprimtarisë. Shoqëria pritet që të jetë operacionale në të ardhmen e parashikueshme përveç rasteve kur ortakët vendosin ndryshimin e modelit të saj të biznesit.

**Transaksionet në monedhë të huaj.** Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës në të cilën ka ndodhur transaksioni. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

### 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si më poshtë:

Foreign Exchange Rate	2023		2022	
	Mesatar	Mbyllje	Mesatar	Mbyllje
Euro/ALL	108.75	103.88	118.92	114.23
USD/ ALL	100.62	93.94	113.15	107.05

**Instrumentet financiare.** Instrumentet financiare të shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Instrumentet financiarë (aktivet dhe detyrimet) njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar çdo kosto transaksioni që lidhet me to në atë datë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktore të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktore të shoqërisë ndaj flukseve të parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

**Mjete monetare dhe depozitat me afat.** Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse me bankat. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten me kosto të amortizuar. Depozitat me afat përfshijnë llogari bankare me maturitet mbi tre muaj dhe maten gjithashtu me kosto të amortizuar.

**Kapitali.** Kuota e kapitalit të shoqërisë njihet me vlerën e saj nominale.

**Aktive afatgjata materiale.** Paisjet mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësim, kur ka të tillë. Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të pajisjeve njihen në rezultatin e periudhës gjatë të cilës ato kryhen.

Amortizimi regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave përmes metodës së vlerës së mbetur. Normat e zhvlerësimit janë si më poshtë:

Automjete	20%
Pajisje zyre dhe dhomash	20%
Kompjuterë dhe Serverë	25%

Normat e zhvlerësimit dhe vlerat e mbetura të aktiveve afatgjata materiale, kur janë të rëndësishme, rishikohen çdo vit.

Fitimet ose humbjet nga dalja jashtë përdorimit llogariten duke krahasuar shumat e marra me vlerën kontabël neto të aktivitetit dhe regjistrohen si të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave.

**Aktivitet afatgjata jo-materiale.** Aktivitet afatgjata jo-materiale të shoqërisë kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe përfshijnë programe kompjuterike të blera. Licencat e programeve kompjuterike të blera kapitalizohen në bazë të koston së blerjes dhe të vënies në punë. Aktivitet afatgjata jo-materiale maten me kosto minus amortizim të akumuluar. Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivitetit për të cilin kryhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në rezultatin e periudhës gjatë të cilës janë kryer. Amortizimi regjistrohet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke filluar nga data kur aktivi është i përdorshëm. Norma e amortizimit është 25%.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

*Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe*

### 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

#### Zhvlerësimet.

*Aktivet financiare.* Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje që kanë ndodhur kanë efekt negative ndaj flukseve të ardhshme të parashikuara të aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Në sajë të numrit të kufizuar të debitorëve, shoqëria kryen gjithmonë analizë individuale dhe jo në grup.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes fillestare nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*Aktivet jo-financiare.* Aktivet jo-financiare të shoqërisë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### Përfitimet e punonjësve

Shoqëria llogarit shpenzimet dhe detyrimet për pagat, kontributet për sigurimet, bonuset dhe përfitimet jo-monetare në vitin në të cilin ajo ka përfitur shërbimet e punonjësve të saj. Shpenzimet që i takojnë Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën në të cilën ato ndodhin. Shoqëria nuk ka detyrime të tjera përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore shtetërore.

**Provizionet.** Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe që për shlyerjen e tij ka gjasa të daljes së përfitimeve ekonomike. Provizionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë përmes një norme para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të lidhura me detyrimin në fjalë.

**Njohja e të ardhurave.** Të ardhurat llogariten në bazë të marrëveshjes së nivelit të shërbimit (SLA) të lidhur midis shoqërisë dhe ortakëve të saj e cila në thelb vendos një marzh 2% mbi shpenzimet që ndesh shoqëria gjatë kryerjes së shërbimeve ndaj tyre. Shërbimet e shoqërisë përfshijnë trajtimin e dëmeve të sigurimit, shërbime të teknologjisë së informacionit dhe raportimin financiar e kontabilitetin për ortakët të cilët janë filiale të Vienna Insurance Group në Shqipëri. Shoqëria i lëshon faturat çdo muaj, 7 ditë pas përfundimit të muajit. Të ardhurat paraqiten pa TVSH, zbritje apo korrigjime. Të ardhurat njihen përgjatë kohës së kryerjes së shpenzimeve përkatëse.

**Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.** Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat prej fondeve të investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. E ardhura nga interesat njihet duke përdorur metodën e interesit efektive.

**Shpenzimet për tatim fitimin.** Shpenzimi për tatim fitimin përfshin tatimin aktual për vitin dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i vitit financiar ka të bëjë me tatimin mbi fitimin e pagueshëm të llogaritur duke përdorur normat dhe rregullat tatimore gjatë vitit financiar. Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit për diferenca të përkohshme që lindin midis zërave të pasqyrave financiare dhe bazave të tyre tatimore. Tatimet e shtyra maten me normat tatimore në fuqi apo që pritet të jenë në fuqi kur diferencat e përkohshme të mbyllen.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

### 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

**Tatimi i vlerës së shtuar (TVSH).** Tatimi i vlerës së shtuar që lidhet me shitjet e shoqërisë është i pagueshëm ndaj autoriteteve tatimore në datën më të hershme midis (a) arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga klienti ose (b) kur kryhet shërbimi. TVSH-ja kreditore mund të kompensohet me atë debitorë. TVSH-ja kreditore apo debitorë paraqitet neto në pasqyrën e pozicionit financiar si aktiv ose detyrim.

### 3. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

	2023	2022
<i>Llogari rrjedhëse me bankat</i>		
LEK	4,354,224	19,243,010
EUR	1,704,278	551,169
<b>Totali</b>	<b>6,058,502</b>	<b>19,794,179</b>

Mjete monetare janë vendosur në llogari rrjedhëse me 4 banka tregtare, kryesisht banka me kapital të huaj. Bankat me të cilat shoqëria bashkëpunon janë vlerësuar me A+ dhe BBB-. Shoqëria nuk ka njohur humbje zhvlerësimi pasi nuk ka identifikuar ngjarje apo të dhëna objektive zhvlerësimi për mjetet monetare.

### 4. Depozita me afat

	2023	2022
Depozita me afat	10,000,000	-
Interesa të përlllogaritur	33,288	-
<b>Totali</b>	<b>10,033,288</b>	<b>-</b>

Depozitat me afat janë vendosur me Bankën Kombëtare Tregtare (BB-). Shoqëria Kompani ka vendosur likuiditetet në dispozicion në depozita me afat për një periudhë një vjeçare nga data 15 nëntor 2024, me të drejtë rinovimi. Depozita paguan interes 2.7% në vit.

### 5. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga:

	2023	2022
Sigma VIG	4,342,547	3,796,973
Intersig VIG	6,671,563	3,436,606
Other	14,835	-
<b>Totali</b>	<b>11,028,945</b>	<b>7,206,579</b>

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshmet e papaguara nga palët e lidhura për shërbimet e ofruara për aksionarët e kompanisë në përputhje me kontratën e shërbimit. Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe përgjithësisht janë të pagueshme brenda 30 ditëve.

### 6. Aktive të tjera

	2023	2022
Shpenzime të parapaguara	2,313,591	2,710,836
Tatim në burim	259,221	259,221
Parapagime personeli	71,309	79,715
<b>Totali</b>	<b>2,644,121</b>	<b>3,049,772</b>

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

### 7. Aktive afatgjata materiale

	Automjete	Mobilje dhe pajisje zyre	Kompjuterë dhe serverë	Totali
<i>Kosto</i>				
<b>Më 1 janar 2022</b>	11,699,381	8,059,191	31,645,593	51,404,165
Shtesat	3,630,100	287,527	1,268,500	5,186,127
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,329,406)	-	-	(1,329,406)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>14,000,075</b>	<b>8,346,718</b>	<b>32,914,093</b>	<b>55,260,886</b>
Shtesat	-	98,625	7,869,353	7,967,978
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(6,880,290)	(6,880,290)
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>14,000,075</b>	<b>8,445,343</b>	<b>33,903,156</b>	<b>56,348,574</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
<b>Më 1 janar 2022</b>	7,533,912	4,751,932	22,915,331	35,201,175
Shpenzimi i periudhës	1,076,813	708,032	2,376,780	4,161,625
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,178,333)	-	-	(1,178,333)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>7,432,392</b>	<b>5,459,964</b>	<b>25,292,111</b>	<b>38,184,467</b>
Shpenzimi i periudhës	1,313,537	672,602	2,806,293	4,792,432
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(6,880,290)	(6,880,290)
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>8,745,929</b>	<b>6,132,566</b>	<b>21,218,114</b>	<b>36,096,609</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>				
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>6,567,683</b>	<b>2,886,754</b>	<b>7,621,982</b>	<b>17,076,419</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>5,254,146</b>	<b>2,312,777</b>	<b>12,685,042</b>	<b>20,251,965</b>

### 8. Aktivët afatgjata jo-materiale

	Programe kompjuterike
<i>Kosto</i>	
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>25,756,332</b>
Shtesa	9,286,436
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>35,042,768</b>
Shtesa	-
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>35,042,768</b>
<i>Amortizim i akumuluar</i>	
<b>Më 1 Janar 2022</b>	<b>14,298,057</b>
Amortizimi i periudhës	4,025,374
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>18,323,431</b>
Amortizimi i periudhës	4,230,257
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>22,553,688</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>	
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>16,719,337</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>12,489,080</b>

## VIG Services Shqipëri SH.P.K.

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

#### 9. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga:

	2023	2022
Llogari te pagueshme:		
- Furnitorë vendas	1,155,454	1,754,695
- Furnitorë te huaj	1,271,838	2,475,982
<b>Totali</b>	<b>2,427,292</b>	<b>4,230,677</b>

#### 10. Provizione

	2023	2022
Provizion për çështje gjyqësore	5,123,572	5,123,572
<b>Totali</b>	<b>5,123,572</b>	<b>5,123,572</b>

Provizionet për çështje gjyqësore kanë të bëjnë me çështje të ngritura kundër shoqërisë nga ish punonjës të saj (tre). Drejtuesit janë të mendimit që nuk do të ketë humbje të mëtejshme nga ato që janë njohur në pasqyrat financiare duke qenë se ata kanë pasqyruar vendimet e shkallëve të para të gjykimit.

#### 11. Llogari të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme të tjera përbëhen nga:

	2023	2022
TVSH e pagueshme	758,483	1,037,188
Sigurime shoqërore të pagueshme	202,094	173,071
Tatim mbi te ardhurat personale	273,763	216,030
Detyrime ndaj personelit	7,388	-
<b>Totali</b>	<b>1,241,728</b>	<b>1,426,289</b>

#### 12. Kapitali

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga dy kuota (2022: 2) të cilat i korrespondojnë të drejtave të votimit dhe janë paguar plotësisht. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, struktura e pronësisë ishte si më poshtë:

	Kuota	Në Lekë	%
Sigma VIG SH.A	1	21,169,875	50%
Intersig VIG SH.A	1	21,169,875	50%
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>42,339,750</b>	<b>100%</b>

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

### 13. Të ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet që shoqëria kryen janë si më poshtë:

	2023	2022
Sigma VIG Sh.a	34,570,368	33,787,397
Intersig VIG Sh.a	26,318,194	25,098,945
Te tjera	6,188	45
<b>Totali</b>	<b>60,894,750</b>	<b>58,886,387</b>

Siç përcaktohet në marrëveshjen e nivelit të shërbimit të lidhur midis shoqërisë dhe ortakëve të saj (SLA), të ardhurat llogariten me kosto plus 2% marzhë. Sipsa SLA, shoqëria kryen shërbime të tilla si ato të trajtimit të dëmeve, të teknologjisë së informacionit dhe shërbimet e raportimit financiar dhe kontabilitetit. Për shpenzimet e trajtimit të dëmeve të sigurimit, shoqëria e kryen shpërndarjen ndaj ortakëve në varësi të numrit të dëmeve të raportuara TPL dhe Kasko. Për raportimin financiar, shpenzimet shpërndahen në varësi të primit të shkruar bruto të secilit ortak pas zbritjes së kontratave të risigurimit fronting. Për shërbimet e teknologjisë së informacionit, shpenzimet shpërndahen në bazë të numrit të përdoruesve ndërsa shpenzimet administrative shpërndahen në mënyrë të barabartë.+

#### 13.1 Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera të vitit kanë të bëjnë me shitje materiale skrap ndërsa në vitin 2022 me fitimin nga shitja e aktiveve afatgjata materiale.

### 14. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	2023	2022
Pagat	13,464,364	12,639,098
Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore	1,158,231	1,020,184
<b>Totali</b>	<b>14,622,595</b>	<b>13,659,282</b>

### 15. Shpenzime administrative

	2023	2022
Shpenzime IT	10,688,079	11,603,354
Qira	9,137,660	10,008,810
Shpenzime kancelarie	3,407,890	4,091,881
Shpenzime mirëmbajtje	3,605,409	3,196,694
Shpenzime këshillimi	1,750,130	972,000
Shpenzime për shërbimet universale (energji, ujë)	1,866,942	1,765,700
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	1,477,924	584,219
Karburant	1,433,000	1,572,980
Shërbime sigurie	792,250	597,500
Shpenzime telefonie dhe poste	649,935	765,640
Auditim i jashtëm i pasqyrave financiare	323,852	414,906
Taksa lokale	82,600	101,700
Gjoha	205,286	-
Shpenzime të tjera	1,005,330	626,862
<b>Totali</b>	<b>36,426,287</b>	<b>36,302,246</b>

Shpenzimet e tjera përfshijnë komisionet bankare, shpenzimet e përfaqësimit dhe të tjera administrative.

# VIG Services Shqipëri SH.P.K.

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

### 16. Shpenzime për tatim fitimin

Pasqyra më poshtë paraqet një llogaritje të fitimit të tatueshëm dhe ndryshimit në tatim:

	2023	2022
Shpenzimi për tatim fitimin aktual	418,545	198,358
<b>Shpenzimi për tatim fitimin</b>	<b>418,545</b>	<b>198,358</b>

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri llogaritet me 15% të fitimit të tatueshëm (fitimit para tatimit) pas rregullimit për shpenzimet e pazbritshme. Rakordimi i tatim-fitimit të pritshëm dhe atij aktual jepet në vijim.

	2023	2022
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>647,562</b>	<b>699,802</b>
Tatimi sipas normës ligjore 15%	97,134	104,970
Shpenzime të pazbritshme (15%)	321,411	93,388
<i>Shpenzime per konsum personal</i>	<i>141,108</i>	<i>120,762</i>
<i>Shpenzime pa dokumenta</i>	<i>112,414</i>	<i>23,645</i>
<i>Penalitete dhe provigjone</i>	<i>67,889</i>	<i>(51,019)</i>
<b>Fitim i tatueshëm</b>	<b>418,545</b>	<b>198,358</b>

### 17. Palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse janë nën kontroll të përbashkët apo nëse njëra palë kontrollon tjetrën ose kur ka ndikim të rëndësishëm apo kontroll të përbashkët në vendimmarrjen financiare apo operacionale. Në përcaktimin e palëve të lidhura i vihet theksi thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore të saj. Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura, pjesë e të ardhurave jepet si më poshtë:

Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Sigma VIG SH.A. (ortak)	34,570,368	33,787,397
Intersig SH.A. (ortak)	26,318,194	25,098,945
<b>Totali</b>	<b>60,888,562</b>	<b>58,886,342</b>

Blerje	Marrëdhënia	2023	2022
<i>Prime sigurimi</i>			
SigmaVIG Sh.a	Ortak	74,205	146,583
<i>Qira</i>			
Intersig VIG Sh.a	Ortak	9,197,475	10,075,445
<i>Shpenzime IT</i>			
Insurance makedonija	Shoqëri nën kontrollin e grupit	2,707,551	3,868,608
Vienna Insurance Group AG	Shoqëria mëmë e grupit	3,242,044	3,257,987
<i>Kompensimi i drejtimit</i>			
Paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore	Administrator	7,349,441	6,538,760
<b>Totali</b>		<b>22,570,716</b>	<b>23,887,383</b>

## VIG Services Shqipëri SH.P.K.

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në lekë, përveç rasteve kur përmendet ndryshe

#### 17. Palët e lidhura (vazhdim)

Qiraja lidhet me ambientet e zyrave të shoqërisë. Ndërtesa e marrë me qira është në pronësi të Intersig VIG SH.A. Insurance Makedonija dhe Vienna Insurance Group kryejnë shërbime në lidhje me SAP, MBA dhe shërbime të tjera IT.

Në fund të vitit, shoqëria kishte gjendjet në vijim me palët e lidhura:

	2023	2022
<b>Llogari të arkëtueshme tregtare</b>		
Te arkëtueshme nga Intersig VIG Sh.a	4,342,547	3,769,973
Te arkëtueshme nga Sigma VIG Sh.a	6,671,563	3,436,606
<b>Totali</b>	<b>11,014,110</b>	<b>7,206,579</b>
<b>Llogari të pagueshme tregtare</b>		
Detyrime ndaj Insurance Makedonija	654,444	1,405,029
Detyrime ndaj Vienna Insurance Group AG	617,394	1,070,953
<b>Totali</b>	<b>1,271,838</b>	<b>2,475,982</b>

#### 18. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

##### Angazhime qeraje

Shoqëria i paguan qira vjetore Intersig VIG SH.A.-së për përdorimin e ambienteve të saj. Angazhimet minimale të qirasë sipas kontratës paraqiten si më poshtë:

	2023	2022
Jo më vonë se një vit	8,725,920	9,595,320
2 deri në 5 vite	34,903,680	38,381,280
Mbi 5 vite	-	-
<b>Totali</b>	<b>43,629,600</b>	<b>47,976,600</b>

#### 19. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.